



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 140/10 prot.

Datë 08.03.2024

V E N D I M

Nr. 258/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.03.2024 , mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 206/2024, datë 21.02.2024 për procedurën e prokurimit prokurimit REF-93015-01-11-2024, me objekt: “Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyresh për Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik, ‘Mbretëresha Geraldinë’”, me fond limit 41,171,800.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 12.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “KLAME” SHPK me NIPT K21518003F dhe adresë: Rruga “Gani Kryeziu” Nr.23, kati i dytë, Njësia Administrative 11, Kodër Kamëz, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.
Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 21.02.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.206/2024, ku vendosi: [...]

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik "KLAME" SHPK, për procedurën e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar", me Nr. REF-93015-01-11-2024 me objekt: "Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash për Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik, 'Mbretëresha Geraldinë'", me fond limit 41,171,800.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 12.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "KLAME" SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "KLAME" SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. .

I.2. Me shkresën nr. 97/5 prot., datë 28.02.2024, protokolluar me tonën nr. 140/7 prot., datë 04.03.2024 autoriteti kontraktor, njofton se "Me shkresën nr. 140/6 prot., date 21.02.2024 (protokolluar me tonën nr. 97/4 prot., date 26.02.2024) me lende "Dërgim vendimi", Komisioni i Prokurimit Publik ka derguar prane Agjencise Shtetërore te Prokurimeve te Perqendruara, Vendimin nr.206/2024 date 21.02.2024 ne lidhje me ankesën e operatorit ekonomik "Klame" SHPK për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje orendi dhe pajisje per mobilim zyrash per Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekolgjik "Mbreteresha Geraldine" me fond limit 41,171,800 (dyzete e nje milion e njeqind e shtatedhjetë e një mije e tetëqind) leke (pa TVSH), me numer reference REF-93015-01-11-2024 parashikuar për t'u zhvilluar ne date 12.02.2024.

Ne date 23.01.2024 me ane te email-it zyrtar si dhe ne rrugë shkresore, organi qendror bleses eshte njohur me shkresën nr.81 prot., date 23.01.2024, (protokolluar me tonën nr.103 prot., date 24.01.2024) me lende "Mbi anulimin e procedures se prokurimit me nr. të references REF-93015-01-11-2024" , me ane te se cilës autoriteti kontraktor Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekolgjik "Mbretëresha Geraldine" i ka kerkuar ASHPP anulimin e procedures me objekt "Blerje orendi dhe pajisje per mobilim zyrash" per te berë te mundur rishikimin e disa prej zërave objekt prokurimi deri ne sakesimin e plote te te dhenave me qellim mbulimin e plotq të nevojave. Për sa me siper, ne zbatim te vendimit nr.206/2024 prot.,date 21.02.2024 te Komisionit te Prokurimit

Publik (KPP) si dhe bazuar ne kerkesën e ardhur nga autoriteti kontraktor SUOGJ "Mbretëresha Geraldine" për procedurn e prokurimit me objekt "Blerje orendi dhe pajisje per mobilim zyrash per Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldine» me fond limit 41,171,800 (dyzete e nje milion e njëgind e shtatëdhjetë e nje mije e tetëqind) leke (pa TVSH), me numer reference REF-93015-01-11-2024, ju bejme me dije se në rastin e ri- publikimit te kesaj procedure prokurimi, organi qendror bleses do te kryeje modifikimet përkatëse ne perputhje me arsyetimet dhe konstatimet e KPP si dhe duke u bazuar ne legjislacionin ne fuqi. Bashkelidhur do te gjeni: • Shkresën nr.81 prot., date 23.01.2024 (protokolluar me tonen nr.103 prot., date 24.01.2024) "Mbi anulimin e procedurës së prokurimit me nr. te references REF-93015- 01-11-2024" derguar nga Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldine" për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje orendi dhe pajisje per mobilim zvrash".

Bashkëlidhur shkresa me arsyen e kërkesës për anulim nga ana e Spitalit Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë" me Nr. 81 prot datë 23.01.2024, protokolluar nga Agjencia Shtetërore e prokurimeve të Përqëndruara , Nr.103 prot datë 24.01.2024.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 97/5 prot., datë 28.02.2024, protokolluar me tonën nr. 140/7 prot., datë 04.03.2024 autoriteti kontraktor, njofton se "Me shkresën nr. 140/6 prot.,date 21.02.2024 (protokolluar me tonën nr. 97/4 prot., date 26.02.2024) me lende "Dërgim vendimi", Komisioni i Prokurimit Publik ka derguar prane Agjencise Shteterore te Prokurimeve te Perqendruara, Vendimin nr.206/2024 date 21.02.2024 ne lidhje me ankesën e operatorit ekonomik "Klame" SHPK për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje orendi dhe pajisje per mobilim zyrash per Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldine" me fond limit 41,171,800 (dyzete e nje milion e njeqind e shtatedhjetë e një mije e tetëqind) leke (pa TVSH), me numer reference REF-93015-01-11-2024 parashikuar për t'u zhvilluar ne date 12.02.2024.

Ne date 23.01.2024 me ane te email-it zyrtar si dhe ne rrugë shkresore, organi qendror bleses eshte njohur me shkresën nr.81 prot., date 23.01.2024, (protokolluar me tonën nr.103 prot., date 24.01.2024) me lende "Mbi anulimin e procedures se prokurimit me nr. të references REF-93015-01-11-2024" ", me ane te se cilës autoriteti kontraktor Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldine" i ka kerkuar ASHPP anulimin e procedures me objekt "Blerje orendi dhe pajisje per mobilim zyrash" per te berë te mundur rishikimin e disa prej zërave objekt prokurimi deri ne sakesimin e plote te te dhenave me qellim mbulimin e plotq të nevojave. Për sa me siper, ne zbatim te vendimit nr.206/2024 prot.,date 21.02.2024 te Komisionit te Prokurimit Publik (KPP) si dhe bazuar ne kerkesën e ardhur nga autoriteti kontraktor SUOGJ "Mbretëresha Geraldine" për procedurn e prokurimit me objekt "Blerje orendi dhe pajisje per mobilim zyrash per Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldine» me fond limit 41,171,800 (dyzete e nje milion e njëgind e shtatëdhjetë e nje mije e tetëqind) leke (pa TVSH), me numer reference REF-93015-01-11-2024, ju bejme me dije se në rastin e ri- publikimit te kesaj procedure prokurimi, organi qendror bleses do te kryeje modifikimet përkatëse ne perputhje me

arsyetimet dhe konstatimet e KPP si dhe duke u bazuar ne legjislacionin ne fuqi. Bashkelidhur do te gjeni: • Shkresën nr.81 prot., date 23.01.2024 (protokolluar me tonen nr.103 prot., date 24.01.2024) "Mbi anulimin e procedurës së prokurimit me nr. te references REF-93015- 01-11-2024" derguar nga Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Mbreteresha Geraldine" për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje orendi dhe pajisje per mobilim zvrash.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni Prokurimit Publik gjykon se është në të drejtën e autoritetit kontraktor për të anuluar procedurën, lidhur me argumentimin e kryer.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për anulimin e procedurës "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar", me Nr. REF-93015-01-11-2024 me objekt: "Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyresh për Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik, 'Mbretëresha Geraldinë'", me fond limit 41,171,800.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 12.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.
2. Autoriteti kontraktor me rihedhjen e procedurës objekt ankimi të paraqesë pranë Komisionit Prokurimit Publik dokumentet e procedurës, me pasqyrimet sipas konstatimit të vendimit Nr.206/2024, datë 21.02.2024 të Komisioni i Prokurimit Publik.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

